



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL¹

(I përmbledhur)

Tiranë, më 02.04.2019, ora 12.00

Drejton mbledhjen
Ardian Dvorani – Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës :

1. Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Marrin pjesë² :

- | | |
|--------------------------|-----------------------|
| 1. Ardian Dvorani | (kryetar) |
| 2. Vitore Tusha | (zëvendës kryetare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |
| 4. Fatri Islamaj | (anëtar) |
| 5. Margarita Buhali | (anëtare) |
| 6. Eriol Roshi | (anëtar) |
| 7. Medi Bici | (anëtar zëvendësues) |
| 8. Gurali Brahimllari | (anëtar zëvendësues) |
| 9. Klodiana Veizi (Mema) | (anëtare zëvendësues) |

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike qëndrimet dhe diskutimet e plota të vetë anëtarëve të KED, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

² Anëtarja e Fatjona Memçaj nuk merr pjesë në diskutimin dhe miratimin e akteve nënligjore normative, për shkak të papajtueshmërisë-marrëdhënie krushqie e afërt me kandidaten Ardita Alsula. Sipas ligjit, Kryetari i Këshillit e ka miratuar heqjen dorë me vendimin nr.1 datë 14.02.2019.

Merr pjesë, si vëzhguese e përhershme :

1. Erinda Ballanca, Avokati i Popullit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguar në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016 :

1. Bledar Dervishaj, përfaqësues i Presidentit të Republikës.
2. Mimoza Arbi, përfaqësuese e Kryetarit të Kuvendit

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga institucionet ndërkombëtare, mbështetëse të procesit të hartimit të akteve nënligjore të KED :

1. Agnes Bernard, shefe e misionit EURALIUS
2. Julinda Beqiraj, eksperte e EURALIUS
3. Maniela Sota, Koço Bendo, përkthyes për EURALIUS

HAPET MBLEDHJA

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, deklaron të hapur mbledhjen.

Verifikohet prania dhe pjesëmarrja e anëtarëve të Këshillit.

Ardian Dvorani lexon çështjet e rendit të ditës të njoftuar paraprakisht:

Diskutimi dhe miratimi i Projektvendimit për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Shtrohet për diskutim miratimi i rendit të ditës së paraqitur për këtë mbledhje të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit miratojnë rendin e ditës së programuar.

Këshilli vijon mbledhjen me diskutimin e projektshtojcave mbi kriteret e vlerësimit dhe metodologjinë e pikëzimit të kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën Kushtetuese dhe atë për Inspektor i Lartë i Drejtësisë, si pjesë e projektvendimit normativ *Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

Ardian Dvorani, si relator i projektaktit, duke pasur parasysh edhe detyrat e lëna nga mbledhja e mëparshme, parashtron punën e bërë së bashku me ekspertët e Euralius në reflektimin në dy projektshtojcat të mendimeve, sugjerimeve dhe qëndrimeve të dakordësuara nga Këshilli lidhur me strukturën, ndarjen dhe shpërndarjen e kritereve të vlerësimit dhe të pikëve etj.

Pas këtij parashtrimi hyrës, meqenëse për reflektimin e ndryshimeve në këto projektshtojca është punuar së bashku me Euralius, pasi merr miratimin e anëtarëve, i kërkon **Agnes Bernhard** të bëjë një parashtrim mbi punën e bërë dhe për ecurinë e mëtejshme të diskutimit drejt miratimit të këtyre projektakteve.

Agnes Bernhard (*përkthen përkthyesja*), mbi kërkesën e anëtarëve të Këshillit për të dhënë mendime, merr fjalën dhe parashtron se strukturën e projektaktit e kemi ruajtur të njëjtë. E tha edhe kryetari që jemi munduar të shmangnim parashikimet e dyfishta. Në meritat profesionale kemi tre nëndarje të ndryshme. E para është e shkuara profesionale dhe eksperiencia. Këtu kemi vjetërsinë për të cilën jepen deri 4 pikë, duken pasur parasysh që njohuritë dhe përvojat profesionale kanë vlerë më të madhe krahasuar me vjetërsinë, si edhe rekomandimet evropiane që vjetërsia si e tillë nuk duhet të jetë shkak i vetëm për rritjen në detyrë. Ndërsa nëndarja tjetër ka të bëjë me sferën e arsimit dhe kualifikimeve. Në anën e majtë janë kriteret ligjore dhe referencat përkatëse. Propozimi është për të dhënë deri në 8 pikë ku masteri ka 1 pikë, shkolla e magistraturës ka 1 pikë, doktoratura ka 2 pikë dhe pastaj titujt akademikë 2 pikë. Pastaj 2 pikë të tjera për kualifikimit pasuniversitare që i referohen specifikisht fushave të së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut dhe sfera të tjera të së drejtës. Gjithashtu kanë pikë edhe trajnimet profesionale dhe edhe studimet afatgjata jashtë shtetit. Pikët jepen për ato trajnime për të cilat është dhënë një certifikatë vlerësimi me një afat minimal pjesëmarrje. Kjo mund të elaborohet nga metodologjia. Pastaj vijnë njohuritë për gjuhën e huaj duke përcaktuar deri në 4 pikë për këtë komponent. Këtu rekomandohet që 2 gjuhët kryesore të jetë Anglishtja dhe Frengjishtja, si gjuhët që përdor edhe Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në ndarjen tjetër është pikëzimi përsa i takon vlerësimit të përgjithshëm profesional. Kjo mendohet që të jetë komponenti me kryesor i vlerësimit do të bëjë si të thuash edhe kategorizimin e kandidatëve nga shumë të mirë, të mirë dhe më pak të mire. Mund tu kërkohet kandidatëve të identifikojnë 3 deri në 5 punët e tyre intelektuale më të mira. Pastaj Këshilli duhet të bëjë vlerësimin e këtyre dokumentave duke patur parasysh disa tregues. Këtu në kolonë kemi disa tregues të cilat mund të kenë pikët përkatëse dhe mund ti elaboroni më tej në metodologjinë tuaj. Ndarja tjetër është ajo që quhet kualifikim i veçantë apo shtesë profesional. Dhe ky ndahet përsëri në dy kritere. I pari, përsëri ndahet në dy

opisone alternative sepse nga njëra anë ligji parashikon ekspertizën përsa i takon të drejtës kushtetuese edhe të drejtat e njeriut, nga ana tjetër ekspertizën që kandidati mund të ketë në sfera të tjera të së drejtës. Siç e biseduam, përbërja e gjykatës kushtetuese, idealja do të ishte, që të kishte njohuri nga fusha të ndryshme të së drejtës dhe ekspertizë të ndryshëm. Ideja është që kandidatët të vlerësohen duke i dhënë të njëjtën numër pikësh. Ka edhe një komponent tjetër që nuk është marrë parasysh në këto në nënndarjet e mëparshme, pjesëmarrja në aktivitete e në punë shkencore qoftë brenda vendit qoftë jashtë vendit me publikime, kontribute të ndryshme, edhe në përpilimin e legjislacionit brenda fushës së ekspertizës së tij .

Ndërsa në meritat morale, integriteti është i ndarë në tre grupe. E para mund të jetë integriteti dhe performanca etike, këtu propozimi është për ti dhënë 16 pikë. Përsa i takon metodologjisë do të ishte më mirë të ishin ato aspekte që duhet të merreshin parasysh për këtë. E dyta mund të jetë reputacioni dhe imazhi që ka kandidati ku propozohet ti jepen 10 pikë. Këtu janë përcaktuar, janë listuar disa çështje që duhet përsëri të laborohen përsa i takon metodologjisë. Së treti është ose mund të jetë angazhimi përsa i takon shoqërisë civile. Propozimi është për ti dhënë 4 pikë. Në këtë e diskutuam gjatë, por edhe juve mund ta mendoni nëse kjo shifra 4 është e përshtatshme si pikëzim sepse kjo ka të bëjë me angazhimin jashtë sferës profesionale dhe duhen pasur parasysh kufizimet që kanë magistratët. Pra nuk duhet të bëhet shkak për disavantazh paraprakisht për magistratët. Këtu nuk merret parasysh shumë situata e tanishme shqiptare. Por, në Austri është kulturë që juristët ose gjyqtarët të përfshihen në shoqata siç ishte p.sh për një muzeum, ose si pjesë e korit lokal psh për një jetë kulturore lokale ose në iniciativa mjedisore, pastrimi i lagjes. Mund ta mendoni mirë nëse diçka e tillë është e përputhshme me situatën shqiptare. Së fundi vijnë meritat organizative dhe menazheriale. Këtë nuk e kemi ndryshuar krahasuar me herën e fundit, duke patur parasysh që këto aftësitë që janë të listuara këtu janë relevante edhe për gjyqtarët gjatë ushtrimit të detyrës. Edhe për aftësitë e drejtimit e të liderit këtu jepen pak pikë.

Anëtarët e Këshillit diskutojnë në parim për të dy projektshojcat e paraqitura me shtesa dhe ndryshime nga veprimtaria e përbashkët e relatorit dhe ekspertëve të Euralius duke vijuar me shqyrtimin në detaje të Shtojcës nr. 1 “Kriteret e vlerësimit dhe metodologjia e pikëzimit të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese”. Në diskutime anëtarët e evidentuan të paargumentuar caktimin vetëm të një 1 pike për përfundimin e Shkollës së Magistraturës, pa e përcaktuar as edhe çfarë lloj kualifikimi bëhet fjalë. Kjo edhe përkundrajt vendosjes së 4 pikëve për angazhime në shoqërinë civile, aq më tepër kur për magistratët ka kufizime ligjore veprimtarie jashtëgjyqësore dhe kur në Shqipëri mungon kultura e tradita përkatëse. Po kështu u evidentua raport jo i drejtë 6 pikë për arsimimet kundrejt 4 pikë për

gjuhët e huaja, nevoja për ulje të minimumit nën 20 vjet të caktimit të pikëve për vjetësinë, vlera e raportit total të pikëve 60 -30 për merita profesionale-merita morale, si edhe rëndësinë e posaçme të përgatitjes dhe publikimit të metodologjisë së vlerësimit dhe të pikëzimit të kandidatëve.

Erinda Balanca, kërkon fjalën dhe parashtron se shqyrtova kriteret dhe sigurisht një nga gjerat të cilat vlerësoj është puna shume e madhe që është bërë për të arritur për të ndjekur një mënyre praktike për ato elementë teorikë të cilët janë në Kushtetute dhe ligjet për organet e qeverisjes dhe atë për Gjykatën Kushtetuese. Por shikoj përsëri se këto kriteret dhe pikëzime mbeten për persona jo shqiptare; Kur po shpjegonte Agnes, mundohesha të identifikoja veten time e të konsideroja veten time, ndonëse nuk jam kandidat e nuk kam paraqitur asnjë kandidaturë. Por po mendoja veten time çfarë pikësh mund të merrja e çfarë pikësh nuk do mund të merrja dhe në fakt duket shume e vështirë edhe për një kandidat si unë që nuk e quaj veten se jam një nga njerëzit me të parëndësishëm për shkak të atyre të themi meritave profesionale dhe eksperiencës profesionale që kam. Kështu pra ky është problemi kryesor i kësaj metodologjie që nuk përputhet me realitetin shqiptar, aq më tepër kur Këshilli në gjykimin tim ka gabuar por sigurisht është vendimmarrja juaj, kur ka vendosur të dalë me një listë për çdo organ emërtese kur qartësisht ligjet thonë dy, pra që të ndahet vlerësimi për gjyqtarët dhe jogjyqtarët e ku do të konkurronin me njëri tjetrin. Dmth. profesorët do konkurronin me njëri tjetrin. Të paktën kështu më është relatuar sepse nuk kam qenë. Për shkak se këtu qarte kanë prioritet gjyqtarët, edhe për faktin se kanë detyrimin për të bërë trajnime të vazhdueshëm përveç magjistraturës, gjë që avokatet psh nuk e kanë, gjë që ato që janë në administratë publike mund të bëjnë trajnime tek ASPA. Mund ta kenë edhe pedagoget si grada shkencore, por për avokatët natyrisht nuk është kështu. Këto lloj elemente të cilat janë të tëra shumë konkret përsëri nuk arrijnë dot të përcjellin ose përfaqësojnë realitetin shqiptar.

Një element që unë nuk e shoh në këtë shtojcën e që mund të ketë lidhje me këtë vlerësimin për rolin që mund të ketë pasur individi në shoqërinë civile është se a do ketë ndonjë lloj pike për opinione të dërguara nga shoqëria civile. Për shkak se ligji për Gjykatën Kushtetuese e përcakton shprehimisht dhe në do ta bëjmë besoj unë sipas nenit 7/b dhe 7/ç. Aty thuhet qartësisht që institucionet publike që kanë lidhje me sistemin e drejtësisë, organizatat, shoqëritë civile me veprimtari në mbrojtjen e të drejtave të njeriut ose të krijuara për mbrojtjen e interesave të përdoruesve të sistemit të drejtësisë mund të paraqesin opinionet e tyre në lidhje me kandidaturat. Por se për çfarë po i paraqesin këto vlerësime Këshilli do i marri parasysh opinionet e tyre për sa kohë që e ka detyrim. Po flasim për kriterin moral që

jeni duke diskutuar apo për aktivizimin. Unë nuk po them pse nuk është bërë deri tani por po them se na duhet duke qenë se kjo është e shkruar në ligjin për Gjykatën Kushtetuese sepse ne po themi që do vlerësojmë kontributet apo mendimin që ka shoqëria civile apo institucionet e drejtësisë apo organizatat që përfaqësojnë qytetarët dhe përdoruesit e sistemit të drejtësisë. Është e shkruar në ligj për kandidaturat në procedurën e emërimit nga Presidenti dhe ato të Gjykatës së Lartë dhe jo për Kuvendin çuditërisht.

Po kështu, sigurisht Shkolla e Magjistraturës është e rëndësishme për ato që janë gjyqtare, nuk është domosdoshme por është e rëndësishme sepse është një kualifikim më tepër se sa për disa njerëz të tjerë. Ndërkohë që mbetem përsëri skeptike tek ky kriter për përgatitjen e dokumenteve duke i dhënë një afat shumë të shkurtër kandidateve për të përgatitur gjithë këto letra, sa do të kenë mundësi që ti përgatisin. Kjo mund të na krijojë edhe probleme. Prandaj mundohem ta vë veten time në rolin e një kandidati për ta kuptuar më mirë nëse janë të bëshme këto kritere për tu plotësuar apo jo siç janë, ndërkohë që shumë kandidatë kanë paraqitur kandidaturën para një viti dhe nuk i dinin këto kritere që ne jemi duke përcaktuar. Problemi qëndron se nuk janë pak dokumente për tu përgatitur dhe për të kuptuar se cila është rëndësia që mund të kenë, çfarë ndikimi kanë patur në jurisprudence. Si do ta vlerësojmë ne se çfarë ndikimi kanë patur në jurisprudence ?

Përsa i përket çështjes së të drejtave të njeriut, pavarësisht vlerësimit të madh që ne mund të kemi për realitetin shqiptar, për të kuptuar trendin, thelbin e çdo gjëje edhe për Gjykatën tonë Kushtetuese është krahasimi me Gjykatat e vendeve të tjera dhe me Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Një nga problemet më të mëdha për të caktuar standardin edhe në institucionin tim është mungesa e njohurive të gjuhëve të huaja për disa nga ndihmëskomisioneret sepse duhet ta ndjekësh dinamikën e çështjeve që kanë të bëjnë me drejtat e njeriut, me zbatimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe që kjo të mos jetë nëpërmjet përkthimit ne gjykimin tim. Prandaj e ka vënë edhe si kriter ligji për të kuptuar ku duhet të jetë standardi dhe niveli i njohurive të këtyre kandidatëve. Ndaj mendoj që pikët për gjuhët e huaja duhet të jenë aq sa janë propozuar.

Anëtarët e Këshillit vijojnë diskutimet mes tyre dhe dakordësohen me qëndrimin e shumicës së anëtarëve që shpërndarja e përgjithshme e pikëve ndërmjet tre kategorive të meritave të jetë sipas propozimit 60-30-10. Anëtarët diskutuan dhe u dakordësuan të rishpërndajnë pikët tek nënndarja e parë e meritave profesionale duke caktuar 2 pikë për historikun arsimor dhe pikët e tjera të jepen duke u rishpërndarë dhe mënjanuar mbivendosjet e kritereve për kualifikimet pasuniversitare, trainimet, titujt kademikë, gradat shkencore, nivelet master etj. sipas përcaktimeve të peshës së tyre nga Ligji për Arsimin e Lartë. Duke

qenë se përmendet shprehimisht në ligj, u dakordësua që Shkolla e Magjistraturës të identifikohet dhe dallohet në caktimin e pikëve mes kualifikimeve të tjera pasuniversitare por duke pasur parasysh se ka edhe shkolla të tjera profesionale e pasuniversitare. Duhet reduktuar pikët tek kriteri i aktivizimit në veprimtari të shoqërisë civile për të garantuar mosdiskriminim të magjistratëve ndaj kandidatëve të tjerë. Ndërkohë, për gjuhët e huaja, si kriteri i përcaktuar edhe në ligj, të mbetet vlerësimi maksimal me 4 pikë për Gjykatën Kushtetuese. Metodologjia që do të përgatitet pas miratimit të shtojcave të pikëzimit duhet të shpjegojë edhe mënyrën se si do të vlerësohen kandidatët për këto kritere.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E DYTË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me shqyrtimin dhe diskutimet mes anëtarëve rreth Nënndarjes “B. Kualifikimi i Përgjithshëm Profesional”, veçanërisht lidhur me përfshirjen dhe renditjen e kritereve ligjore të vlerësimit në këtë Seksion, peshën specifike dhe pikët maksimale të caktuara për këtë grup kriteresh, qartësinë, plotësinë dhe shtrirjen e indikatorëve të vlerësimit të aftësive profesionale sipas kërkesave të ligjit dhe duke pasur parasysh fushat e ndryshme profesionale nga vijnë kandidatët, si edhe të burimeve dokumentare etj. që Këshilli duhet të mbajë parasysh në procesin e vlerësimit të kandidaturave.

Erinda Balanca, kërkon fjalën dhe parashtron se në lidhje me indikatorët e vlerësimit origjinaliteti dhe impakti, kur themi origjinaliteti është sikur të jetë një krijim i ri, por ti në fakt nuk mund të bësh një krijim të ri. Ti do të referosh dhe do të zbatosh praktikën, një praktikë të caktuar, të konsoliduar dhe në rastin e gjyqtarit për fjalën origjinalitet, ndoshta duhet të gjejmë fjalën e duhur. Për fjalën origjinalitet, fjala që më vjen mua në mendje është që dokumenti të jetë vendim inovativ domethënë një gjë e re që nuk është bërë më përpara. Dhe këtu kjo jo domosdoshërisht është gjë e mirë, jo domosdosmërisht një vendim gjyqësor duhet të jetë origjinal.

Ndoshta tek kjo pjesë ndoshta duhet bërë “origjinaliteti dhe/ose impakti”. E them nga eksperiencia ime, por edhe nga eksperiencia e punonjësve të administratës. Ti mund ta bësh një prezantim të shkëlqyer por parlamenti nuk e miraton: Ose për shembull kandidatët që do të vijnë nga shoqëria civile, çfarë mund të na tregojnë neve ose juve si Këshill. Do të na tregojnë se unë kam bërë kaq fushata të rëndësishme për çështje të të drejtave të njeriut nga të cilat janë

prodhuar dhe kam bërë tre projekt ligje. Impakti mund të jetë zero se ato Kuvendi nuk i ka marrë parasysh dhe nuk i ka miratuar. Prandaj mendoj se duhet të jetë “dhe/ose impakti”.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtron se e nisi edhe avokatja tek lista e indikatorëve ndoshta kjo dhe mund të përfshihet tek aftësitë hulumtuese. Një indikator që mund ti shërbej këtij vlerësimi, mund të ishte sipas mendimit tim edhe aftësia për ti referuar në dokumentin që ka sjellë qoftë burime ndërkombëtare të së drejtës apo vendimeve të Gjykatës Kushtetuese. Pra, në fund të ditës po pretendon të bëhet gjyqtar kushtetues, aftësia për tu referuar saktë edhe në praktikën e tij, ndoshta mund të ishte kriter vlerësues nga Këshilli, sa ky gjyqtar apo prokur gjatë punës së tij apo si jurist i është referuar praktikës së unifikuar tashmë nga GJEDNJ apo vetë Gjykata Kushtetuese ku pretendon të jetë pjesë e saj. Mund të ishin edhe vendime unifikuese nga Gjykata e Lartë për të treguar se ky individ hulumton, zgjidh një çështje me përvojë dhe me cilësi maksimale dhe me burimet e së drejtës.

Po kështu, një jurist administrate i nivelit të lartë është tjetër gjë dhe të funksionosh si gjyqtar është një gjë tjetër. Zoti Dvorani, më kupton. Ai ka punuar para meje, më një karrierë të shkëlqyer tek Ministria e Drejtësisë. Shikohet mënyra apo sesi ky jurist administrate si drejtues, si jurist, e ka shfrytëzuar dijen. Pra, në atë moment kur ligji nuk e thotë dhe në atë moment kur ligji hesht. Në qoftëse do të dilte me ndonjë dokument unë do të jepja pikë vërtetë. Është kurajo, siç e keni bërë ju gjyqtarët edhe për një jurist administrate. Edhe unë kam pasur raste, konsiderohej çudi e madhe, ja që ndodh. Dhe sot i ka dhënë efektet edhe pas 12 vjetësh. Por që nëse sjell ndonjë dokument do ti jepja vërtet pikë për guximin dhe për efektin që ka pasur.

Anëtarët e Këshillit vijojnë diskutimet mes tyre dhe në thelb dakordësohen që mos të ngelemi vetëm tek indikatorët origjinaliteti, impakti, aftësia hulumtuese, zhvillimi logjik, saktësia apo konciziteti, por të përfshijmë tek lista e indikatorëve edhe elementë që mundësojnë të tregojnë aftësitë e shfaqura sipas profilit profesional, për shembull, të veçuar për gjyqtar, jurist etj. ose mund të renditen të gjitha pa i bërë dallimin se për cilin përdoren indikatorët, duke qenë një listë gjithësesi jo shteruese indikatorësh. E njëjta gjë edhe për burimet e vlerësimit. Edhe në këtë kategori kriteresh vlerësimi, për shpjegimin se si do të përdoren në vlerësimin e kandidatëve merr rëndësi që të reflektohen tek metodologjia që Këshilli duhet të përgatisë dhe publikojë pas miratimit të projektaktit.

Anëtarët e Këshillit vijojnë me shqyrtimin dhe diskutimet mbi renditjen dhe shtrirjen e kriterëve ligjore, burimeve dokumentare të vlerësimit dhe listës së indikatorëve që Këshilli mund të përdorë për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve sipas Nënndarjes “C. Kualifikimi Shtesë Profesional” të kategorisë “Meritat profesionale”.

Agnes Bernhard (*përkthen përkthyesja*), pas diskutimeve të zhvilluara mes anëtarëve të Këshillit, kërkon fjalën dhe parashtron se mendoj që me diskutimin jemi mirë. Në këtë Seksion do të shkojmë në një nivel tjetër vlerësimi. Në lidhje me dokumentet që do të paraqesin kandidatët është më e thjeshtë të paraqesin shumë dokumenta dhe sa më shumë ti lejoni ata të sjellin, aq më shumë ata do të sjellin. Por puna juaj do të bëhet më e vështirë. Prandaj, do të ishte më mirë që ju të kërkonit kandidatëve që ata të sjellin 3 apo 5 punime e tyr, që vetë ata i vlerësojnë që janë më të mira. Përndryshe ju rrezikoni që ata të sjellin 20, 30 apo 100 punime dhe ju do të duhet ti vlerësoni ato. Dhe kjo është një gjë mëse e mundshme për një gjyqtar, prokuror apo jurist që ka një eksperiencë 15 vjeçare pune. Është më mirë të paraqitet një numër dokumentash ku kandidati ka treguar aftësitë e tij më të mira. Dhe mund të kemi një numër tjetër të veçantë, pra përveç këtyre dokumenteve që tregon krahas kualifikimit të përgjithshëm profesional edhe kualifikime më të specifikuar. Pra, të ketë punime në një fushë të caktuar. Megjithatë edhe në këtë rast unë sygjeroj duhet të kemi një kufizim në numrin e punimeve.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe në lidhje me kriterin vlerësues të angazhimeve profesionale shtesë parashtron se të mbahen parasysh ata që janë juristë, që vijnë nga jashtë apo edhe për gjyqtarët që marrin pjesë në grupe pune. Përtej përvojës së tyre profesionale të përgjithshme, një pjesë e mirë në administratë janë grupe pune të reformave të mëdha. Nuk po flas vetëm për reformën në drejtësi por edhe në përditshmërinë e administratës ata janë të angazhuar në disa grupe pune dhe kjo është veprimtari profesionale shtesë. Ka edhe angazhime të tjera shtesë si p.sh kur janë përfaqësues në sekretariate teknike në organizma të ndryshme në Këshillin e Europës. Janë angazhime vërtet që duhet të jenë vlerësuar.

Anëtarët e Këshillit vijojnë diskutimet mes tyre dhe në thelb dakordësohen që në përmbajtjen e projektaktit formulimi i kriterëve, burimeve dokumentare dhe indikatorëve të vlerësimit të mos i japin përparësi apo e kundërta kandidatëve për shkak të karrierës dhe profilit të tyre profesional. Prandaj, për vlerësimin e kualifikimit shtesë profesional do të punohet sikurse propozohet në projekt me dy nënndarje alternative që edhe veçmas mund të vlerësohen me pikët maksimale (8 pikë), pra njohuri të posaçmë, të spikatura në të drejtën kushtetuese dhe të drejtat e njeriut, si edhe për njohuri të posaçme në fusha të tjera të së drejtës. Ose të dyja së bashku. Me synimin e krijimit të mundësive për të garantuar prurje të balancuara në Gjykatën Kushtetuese nga profile profesionale dhe fusha të ndryshme të së drejtës. Ndërsa tek angazhimet shtesë profesionale lista e burimeve dokumentare dhe e indikatorëve vlerësues të përfshijë jo në mënyrë shteruese, sikurse e kërkon ligji, veprimtari që tregojnë vërtet kontribute të nivelit të lartë ose të vlerësuar apo që janë të një profili cilësor

profesional. Për kualifikimin profesional shtesë kandidatët mund të paraqesin dokumente profesionale që tregojnë fushën e specializimit, duke përsëritur rendin gjatë përvojës së punës, përfshirë por pa u kufizuar në 5 dokumentet e paraqitura për qëllimet e vlerësimit të kualifikimit të përgjithshëm profesional.

Anëtarët e Këshillit vijnë me shqyrtimin dhe diskutimet mes anëtarëve për kategorinë e dytë të kriterëve të vlerësimit “Meritat Morale”. Përtej dakordësisë së përgjithshme për të caktuar një maksimum prej 30 pikësh kësaj kategorie, u diskutua si thelbësore për reflektimin në përmbajtjen e projektit edhe të parimeve dhe standardeve ndërkombëtare si p.sh Parimet e Bangalorit etj., veçanërisht në pjesët “Integriteti etik e moral” dhe “Reputacioni” të burimeve dokumentare dhe veçanërisht të indikatorëve të vlerësimit në kushtet kur meritat morale janë më të vështira për tu matur, si edhe për elementë të nevojshëm që duhet të shpjegohen qartë në Metodologjinë e vlerësimit që Këshillit do të përgatisë pas miratimit të projektaktit. Anëtar diskutuar dhe riformulimet e nevojshme në pjesën e fundit të vlerësimit “Angazhime në kauzat e shoqërisë civile” si lidhur me peshën dhe numrin e pikëve, pra uljen e pikëve, ashtu edhe me elementët burimore dhe indikatëve të vlerësimit të këtij kriteri për të gjithë kandidatët, pavarësisht nga profilet e tyre profesionale.

Bledar Dervishaj, merr fjalën dhe parashtron se shqyrtova pak burimin se ku do të orientohet Këshilli për të vendosur disa indikator shtesë të cilët mund ti gjejmë edhe tek vetë ligji nr.115. Një nga indikatorët që mund të shtohet është vetë intervista që do të bëjë Këshilli me kandidatët. Përderisa pika 5 e nenit 240 thotë Këshilli interviston kandidatët dhe angazhon ekspertë në vlerësimin e aftësive të tyre mund të përdoret si një indikator. Sepse në traditën tonë ose në llogjikën se si funksionon shteti i së drejtes tek ne jemi mësuar që çdo individ që është pjesë e sistemit ose ne juristët jashtë jemi munduar që të marrim dokumente provues të aftësive profesionale. Ka kandidatë që e kanë të mbushur cv e tyre me certifikata apo trajnime të panumërta që mund të japim pikë më të lartë ndoshta në mënyrë të padrejtë sepse mund të ketë një jurist të mirë në administratën publike që ka kontribute vërtet të shquara që eprorët në 20 e kusur vjet nuk e kanë lënë të bëjë një trajnim. Kështu që intervista me gojë që ky Këshill do të bëjë do të duhet të ketë një peshë të caktuar pikësh për të parë nëse vërtet këto që ka reklamuar me dokumenta qëndrojnë dhe fizikisht sa të krijojnë atë bindjen tuaj të brendshme mbi figurën e këtij gjyqtari kushtetues nesër, çfarë kurajo ka të perballlet me pyetjet, madje edhe ndërtimi i pyetjeve ka shumë rëndësi.

Prandaj unë personalisht vetë kam qenë i intervistuar në një projekt pune fitues në atë projekt e më pas jam përzgjedhur në panel për të intervistuar të tjerët. Nëse do të kisha vendosur të shqyrtoja vetëm dokumentet, do të kisha zgjedhur kandidatët më të

papërshtatshëm. Kështu që e mbështes shumë intervistën dhe e kuptoj letrën me realitetin, ti ballafaqojmë këto të dyja sepse ka njerëz që janë shumë të mirë në të shkruajtur po në të shfaqur jo dhe aq.

Erinda Balanca, kërkon fjalën dhe parashtron se në fakt edhe unë e mbështes shumë këtë edhe duke u nisur nga eksperiencia që institucioni ynë ka pasur për vlerësimin e kandidaturave për anëtarët nga shoqëria civile dhe nga avokatia për organet e tjera. Intervista ka qënë dominante në kuptimin e krijimit të bindjes së secilit prej anëtarëve për cilësitë e kandidatëve. Kështu që intervista duhet të zërë domosdoshmërisht një zë të veçantë ndoshta do të duhet ta bëjmë pak më të strukturuar juve si Komision, dmth të krijohen disa ide se çfarë do të duhet që të pyesni. Nga intervista nxirren të dhëna shumë të rëndësishme për individët sepse jo domosdoshmërisht çdo gjë duket nga letrat. Ashtu si një njeri mund të jetë shumë i spikatur dhe nuk ka bërë shumë trajnime por është jashtëzakonisht i spikatur dhe analitik, ndërkohë që mund të jetë një tjetër që s'ka bërë praktikisht asgjë dhe ja kanë bërë të tëra të tjerët dhe vjen me një bagazh të madh me dokumentacion. Sigurisht që ky Komision duhet ta vlerësojë për atë që ai vlen si individ dhe këtu intervista ka një rol shumë të rëndësishëm.

Në lidhje me kriterin vlerësues të angazhimeve të provuara në kauza të shoqërisë civile mund të bëjmë një interpretim më të gjërë dhe tek indikatorët mund të përfshihen jo vetëm kauza të shoqërisë civile me x shoqatë apo y shoqatë por duke e konsideruar edhe si kauza ato të organizatave profesionale të secilit prej grupeve të interesit, dmth në shoqatën e gjyqtarëve apo të magistratëve të secilit prej grupeve të interesit ose edhe roli i gjithsecilit për reformën në drejtësi.

Anëtarët e Këshillit vijojnë me shqyrtimin dhe diskutimet mes anëtarëve për kategorinë e tretë të kriterëve të vlerësimit “Meritat Organizative, Drejtuese dhe Menaxheriale”.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve e kalojnë me disa shtesa dhe riformulime kategorinë e tretë të kriterëve të vlerësimit “Meritat Organizative, Drejtuese dhe Menaxheriale”.

Përpara ndërprerjes së mbledhjes për një pushim të shkurtër, **Erinda Balanca**, kërkon fjalën dhe parashtron se për sa i përket projektit të Shtojcës për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve për Inspektor i Lartë të Drejtësisë do të mendoja që të marrë pjesë edhe zonja Fatjona Memçaj, duke qënë se në këtë pjesë nuk ka konflikt interesi dhe unë lexova edhe mendimin tuaj në lidhje me miratimin e kërkesës së saj, ku ajo ka bërë kërkesë vetëm për projektaktet që lidhen me Gjykatën Kushtetuese meqenëse një afërme e saj ishte në dy nga listat e kandidatëve dhe jo për këtë pjesë. Qëllimi i legjislatorit, në gjykimin tim, ka qënë që të

krijojë një Këshill duke qene se ka 9 anëtarë , pra një Këshill me një numër të madh anëtarësh ku secili anëtar do përfaqësojë secilin grup të caktuar të sistemit të drejtësisë. Që në fillësë ky Këshill në numër është më pak dhe nuk ka as disa anëtarë zëvendësues. Prandaj unë do të vlerësoja që në këtë Shtojcë të jepte kontributin e saj edhe znj. Memçaj për sa kohë që ajo nuk është ne konflikt interesi në lidhje me përcaktimin e kriterëve të vlerësimit për ILD . Kështu që mendoj se Keshilli duhet ta hedhë këtë gjë në votë dhe duhet të jetë edhe ajo për ta diskutuar e për të pasur komentet e saj në lidhje me këtë Shtojcë.

Ardian Dvorani, në cilësinë e kryetarit të KED me kompetencë për të vendosur për rastet e konfliktit të interesave, në përgjigje të këtij propozimi, shprehet se unë mendoj se ky është një akt normativ i tëri. Rregullat dhe Shtojcat janë një akt normativ i vetëm. Ndaj nuk ka konflikt interesi për një nen por jo edhe për nenin tjetër. Unë e kam të vështirë ta arsyetoj dhe të shkruaj këtë. Por kemi edhe një situatë faktike. Sot 4-5 kandidatë janë candidate si tek vakanca për ILD ashtu edhe për Gjykatën Kushtetuese. Tani kur të vijë (znj. Memçaj) çfarë do të thotë sepse këto akte dhe norma janë të lidhura me njëra tjetrën, nuk mund të shkëputen vlerësimi i pikëve tek ILD nga vlerësimi i pikëve tek Gjykata Kushtetuese. Do të vijë të thotë p.sh. që pikët e meritës profesionale duhet të jenë shumë më tepër në raport me meritat e tjera që vlerësohen dhe kështu duhet të ndryshojë edhe akti tjetër? Gjëja bëhet shumë e komplikuar dhe në vend që të bëjmë mire do ta bëjmë më keq. Unë nuk mund të mendoja kështu kur hoqa dorë nga kandidimi im. Një nga arsytet ishte se unë nuk shikoja se si mund ta ndaja veten mes kandidimit tim me kandidimet e tjera. Rregullat janë një dhe të pandara, janë në unitet dhe të lidhura me njëra tjetrën. Unë nuk di të gjej një shembull, manual, që të thotë se një njeri hyn në një mbledhje kolegjiale voton për dy nene, ikën për 4 nene dhe vjen përsëri për 2 nene të tjera.

Këshilli ndërpret diskutimet për një pushim të shkurtër.

PJESA E TRETË E MBLEDHJES

Mbledhja e Këshillit, pas pushimit, vijon me shqyrtimin dhe diskutimet mbi projektin e Shtojcës nr.2 “Kriteret e vlerësimit dhe metodologjia e pikëzimit të kandidatëve për Inspektor i Lartë i Drejtësisë”.

Erinda Balanca, kërkon fjalën dhe parashtron se nuk kam qenë në seancën e kaluar dhe ndoshta është çështje që ridiskutohet. Por një nga pikat që duhen diskutuar lidhur me gjuhët e huaja është mundësia që keni diskutuar për të referuar listën e përkthyesve të

Ministrisë së Drejtësisë, duke i konsideruar ata si ekspertë. Unë në fakt nuk jam dakord, ata nuk kanë metodologjinë ose elementët për të vlerësuar. Ekspertet ne i paguajmë për të bërë përkthimet tona që na duhen për çështjet e punës ne i bëjmë dhe njëherë nga fillimi. Kështu që kam besim shumë të vogël për këtë Duhet të merren ose nga fakulteti që ka kriteret për të vlerësuar nivelin e njohurive, ose nga ana ndonjë qendër e certifikuar nga organizmat ndërkombëtare që bëjnë provimet për TOEFL dhe IELTS dhe e përcaktojnë tamam modelin me pike në lidhje me njohuritë e gjuhëve të huaja. Tashmë kjo mund të bëhet në Shqipëri dhe ka shumë qendra dhe universitete private në Shqipëri që e kanë mundësinë e dhënies së këtij lloji provimi. Për sa i përket gjuhëve të huaja që vlerësohen, jam dakord që mjafton të njohë dhe kuptojë një nga këto dy gjuhët e punës sepse ne nuk po flasim që kandidati duhet të jetë ekselent.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve, vlerësuan dhe u dakordësuan për ndryshimet dhe riformulimet e nevojshme tek kjo Shtojcë bazuar në të njëjtat qëndrime të mbajtura për Shtojcën e vlerësimit të kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Ndërsa lidhur me shpërndarjen e pikëve mes tre kategorive të meritave për Shtojcën lidhur me ILD raporti do të jetë i ndryshëm 50-25-25 duke pasur parasysh cilësi pak më të ndryshme të kërkuara për këtë funksion kushtetues. Gjithashtu, ndryshime ka edhe në lidhje me shpërndarjen e pikëve, kriteret e vlerësimit, burimet si edhe indikatorët përkatës në seksionet e Kualifikimit të Përgjithshëm Profesional dhe Kualifikimeve Profesionale Shtesë, kjo në përputhje me natyrën e funksionit, profilizimin, specializimin, përvojat e veçanta profesionale dhe menaxhuese, si edhe pritshmëritë në përzgjedhje për kandidatët për ILD. Në lidhje me gjuhët e huaja u dakordësua që në Metodologji të shpjegohet mënyra e vlerësimit të këtyre njohurive ku krahas certifikatës kandidatëve do të kërkohej ti nënshtrohen vlerësimit të gjuhëve të huaja nga Këshilli të ndihmuar edhe nëpërmjet mendimit të ekspertëve dhe me pikë shtesë për njohjen e gjuhë të tjera të huaja me certifikatë nga institucionet kompetente. Ekspertët do të përzgjidhen me vendim të Këshillit.

Anëtarët e Këshillit, në përmbyllje të shqyrtimit në parim dhe nën për nën të dispozitave të projektaktit dhe të dy shtojcave, sipas dakordësisë në mbledhjet e mëparshme vijoj me diskutimet mbi reflektimin në zbardhje të përmbajtjes së disa normave (*pikat 11, 12 e shtuar, 32, 44, 65, 67, 72*) të rëna dakord për tu konsideruar në përfundim të shqyrtimit të projektakteve, përfshirë edhe një nga dispozitat kalimtare lidhur me vakancat e njëkohshme (*pika 79 që bëhet pika 80*).

Erinda Balanca, kërkon fjalën dhe lidhur me dispozitën kalimtare parashtron se arsyeja për të cilën dërgohen dy lista kur ka më shumë se një emërtesë sipas ligjit ka të bëjë

me faktin që secili organ, qoftë Kuvendi qoftë Presidenti i Republikës, duhet të zgjedhë një herë gjyqtar dhe një herë jo gjyqtar. Gjyqtarët duhet të trajtohen midis njëri-tjetrit dhe kandidatët e tjerë të trajtohen midis njëri-tjetrit për efekt të konkurrimit. Dua që ti rri sa më strikt normës së ligjit. Duhet që të lexojmë ligjin dhe në të gjitha rastet, edhe atëhere kur mund të na shkoj për shtat, edhe atëhere kur nuk na shkon për shtat, pavarësisht këshillës së ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët duhet të japin gjykimin në përputhje me ligjin dhe jo të indentifikojnë skenare ekstraligjore, sepse nëse ka skenare ekstraligjore, secili prej antarëve të Këshillit dhe ne që jemi vëzhgues, jemi përpara pikëpyetjes se për çfarë arsye keni vendosur një zgjidhje ekstraligjore.

Ligji e thotë qartë dhe duhet të zbatohet që kur ka më shumë se 1 vakancë duhet të paraqiten 2 lista për secilin rast. Në raportet e mia e kam shënuar dhe kjo nuk ka diskutim që ligji ka shumë probleme dhe që është e qartë pamundësia për tu zbatuar brenda atyre afateve dhe rregullave. Pra përfundimisht e kanë shkruar me këmbë.

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të diskutimeve lidhur me qëllimin dhe përmbajtjen e dispozitave të Kushtetutës dhe të dispozitave ligjore të ligjit nr. 8577/2000 lidhur me rrethanat dhe mundësinë e paraqitjes së dy listave të veçanta për gjyqtarët dhe jogjyqtarët kur ka më shumë se një vakancë për secilin organ emërtese, si edhe lidhur me qëllimin e miratimit të kësaj dispozite kalimtare e kalojnë atë me përmbajtjen vijuese:

“80. Për vendet vakante që tashmë janë krijuar në Gjykatën Kushtetuese të cilat i përkasin të njëjtit organ emërtese, pavarësisht nga përcaktimet e pikës 69 të këtij Vendimi, duke mbajtur parasysh rrethanat e mungesës së njëhershmerisë në shpalljen e vendeve vakante, të kohës së tejzgjatur ndërmjet shpalljeve të konkurrimit për plotësimin e tyre dhe ekzistencën njëkohësisht të vendeve vakante me mandat të plotë dhe të pjesshëm, për të garantuar trajtimin e aplikimeve të kandidatëve në respektim të parimit kushtetues të barazisë përpara ligjit dhe të të drejtës së tyre të zgjedhjes së kandidimit për vende vakante të plotë ose të pjesshme, Këshilli do të procedojë me paraqitjen pranë organit përkatës të emërtesës të një liste të vetme përfundimtare të renditjes së kandidatëve sipas vendit vakant ku kanë shprehur interesin për kandidim.”

Anëtarët e Këshillit, në përfundim të shqyrtimit të dispozitave të projektvendimit “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë” si edhe të dy Shtojcave për kriteret e vlerësimit dhe metodologjinë e pikëzimit të kandidatë për këto funksione, vendosën me votim unaim miratimin në tërësi të tyre.

Kryetari i Këshillit Ardian Dvorani, pasi merr mendimin e anëtarëve për rendin e ditës dhe kohën e mbledhjes së ardhshme, duke u përcaktuar zhvillimi i saj në datën 05 Prill, në orën 10.00, me rend dite shpalljen e fillimit të procedurave për verifikimin, vlerësimin, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve për vendet vakante për anëtar të Gjykatës Kushtetuese dhe Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, si edhe zhvillimin e shortit për caktimin e relatorëve për vendet vakante, deklaroi mbylljen e mbledhjes.

MBLEDHJA MBYLLET NË ORËN 18.49

Sekretare

Dorina Dulaj
Ermelinda Kadiu
Redjona Myrtja

Kryetari

Ardian Dvorani

Shënim: Diskutimet e zhvilluara në gjuhën angleze, janë reflektuar të përkthyer në këtë procesverbal. Përkthimi është kryer nga personel i vetë institucioneve të ftuar.